




Republika e Kosovës

Komuna e Rahovecit

Kabineti i Kryetarit



Njësia Nr./Br./No 02 (Kabineti i Kryetarit të Komunës)

Nr./Br./No 3120 Nr. i faq./Br.str./No.pg 83

Data/Datum/Date 12/12/22

RAHOVEC / ORAHOVAC

LISTA E VENDIMEVE NGA KRYETARI I KOMUNËS SË RAHOVECIT, Z. SMAJL LATIFI: 1-9 DHJETOR 2022

Nr	Emri i vendimit	Nr. Protokollit
1.	Vendim për qasje në dokumente publike	NRP-02-3058-2022
2.	Vendim për caktimin e komisionit për vlerësimin e ofertave	NRP-02-3059-2022
3.	Vendim për caktimin e koordinatorit të Grupit Punues për menaxhimin e rrezikut komunal	NRP-02-3060-2022
4.	Vendim për caktimin e Grupit Punues për hartimin e Listës së Rreziqeve komunale	NRP-02-3061-2022
5.	Vendim për punë shtesë dhe punë të paparapara	NRP-02-3062-2022
6.	Vendim për derivate	NRP-02-3063-2022
7.	Vendim për emërimin e Zyrtarit administrative në kabinetin e Kryetarit të Komunës	NRP-02-3065-2022
8.	Vendim për caktimin e zëvendësuesit të Shefit të sektorit të gjendjes civile	NRP-02-3066-2022
9.	Vendim për caktimin e menaxherit të kontratës dhe mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës	NRP-02-3068-2022
10.	Vendim për caktimin e menaxherit të kontratës dhe mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës	NRP-02-3069-2022
11.	Vendim për caktimin e komisionit për shqyrtimin dhe vlerësimin e aplikacioneve	NRP-02-3070-2022
12.	Vendim për caktimin e juries profesionale për vlerësimin e punimeve dhe përzgjedhjen e krijimtarisë më të mire letrare për dhënien e çmimit letrar "Sulejman Krasniqi"	NRP-02-3071-2022
13.	Vendim për emërimin e Drejtores së Drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim	NRP-02-3073-2022
14.	Vendim për caktimin e komisionit për inventarizimin e pasurive jo financiare dhe financiare	NRP-02-3078-2022
15.	Vendim për ndihmë financiare	NRP-02-3083-2022
16.	Vendim për ndihmë financiare	NRP-02-3084-2022
17.	Vendim për themelimin e Këshillit të Pacientëve	NRP-02-3085-2022
18.	Vendim plotësimi dhe ndryshimi i vendimit	NRP-02-3091-2022
19.	Vendim për ndarjen e subvencioneve për ndihma momentale	NRP-02-3093-2022
20.	Vendim Për caktimin e komisionit për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga prerja e pyjeve në territorin e Komunës së Rahovecit	NRP-02-3094-2022
21.	Vendim për përkrahje financiare	NRP-02-3095-2022
22.	Vendim për caktimin e menaxherit të kontratës dhe mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës	NRP-02-3106-2022

23.	Vendim për caktimin e menaxherit të kontratës dhe mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës	NRP-02-3107-2022
24.	Vendim për caktimin e menaxherit të kontratës dhe mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës	NRP-02-3108-2022
25.	Vendim për caktimin e menaxherit të kontratës dhe mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës	NRP-02-3109-2022
26.	Vendim për caktimin e menaxherit të kontratës dhe mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës	NRP-02-3110-2022
27.	Vendim për caktimin e komisionit pr caktimin e komisionit për vlerësimin e dëmeve	NRP-02-3113-2022
28.	Vendim për refuzimin e kërkesës për pagesën e shpërblimit të përvjetorit (jubile)	NRP-02-3115-2022
29.	Vendim për refuzimin e kërkesës për pagesën e shpërblimit të përvjetorit (jubile)	NRP-02-3116-2022

Rahovec, dhjetor 2022





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



Njësia Nr./Br./No 02 (Kabineti i Kryetarit të Komunës)

Nr./Br./No 3058 Nr. i faq./Br.str./No pg 77

Data/Datën/Date 1 12 / 22

RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Republikës së Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 21 dhe 26 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, nenit 11 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike, nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 i datës 29.03.2017, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M

Për qasje në dokumente publike

1. Miratohet e bazuar kërkesa me Nr. Prot. 5724, e datës 24.11.2022 për qasje në dokumente publike nga znj. Bubulina Peni nga Kallxo.com dhe i ofrohet qasje e plotë në dokumente, dhe atë:
 - 1.1.Kriteret e konkursit "për plotësimin e vendit të punës Drejtor/eshë në SHFMU Heronjtë e Kosovës në Hoçë të Vogël të shpallur nga Drejtoria për Arsim në Komunën e Rahovecit me datën 02.07.2022";
 - 1.2.Vendimin për kandidatin/en e suksesshme;
 - 1.3.CV-në e kandidatit të suksesshëm në konkursin "për plotësimin e vendit të punës Drejtor/eshë në SHFMU Heronjtë e Kosovës në Hoçë të Vogël të shpallur nga Drejtoria për Arsim në Komunën e Rahovecit me datën 02.07.2022";
 - 1.4.Përbërjen e komisionit vlerësues/intervistues dhe pozitat e tyre.
2. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

A r s y e t i m

Në mbështetje të nenit 10 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike (QDP), Komuna e Rahovecit ka pranuar kërkesën me Nr. Prot. 5724, e datës 24.11.2022 për qasje në dokumente publike nga znj. Bubulina Peni nga Kallxo.com për qasje në dokumente publike.

Pas shqyrtimit të kërkesës, të njëjtës i ofrohet qasje e plotë në dokumente publike në lidhje me Kriteret e konkursit "për plotësimin e vendit të punës Drejtor/eshë në SHFMU Heronjtë e Kosovës në Hoçë të Vogël të shpallur nga Drejtoria për Arsim në Komunën e Rahovecit me datën 02.07.2022"; Vendimin për kandidatin/en e suksesshme; CV-në e kandidatit të suksesshëm në konkursin "për plotësimin e vendit të punës Drejtor/eshë në SHFMU Heronjtë e Kosovës në Hoçë të Vogël të shpallur nga Drejtoria për Arsim në Komunën e Rahovecit me datën 02.07.2022"; dhe Përbërjen e komisionit vlerësues/intervistues dhe pozitat e tyre.

Kërkesa për Qasje në Dokumente Publike është pranuar në mënyrë elektronike.

Komuna e Rahovecit, pas shqyrtimit të kërkesës, si dhe pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi, pala e pakënaqur mund të paraqes ankesë në Agjencionin për Informim dhe Privatësi brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga data e pranimet të tij.

Vendimi u dergohet:

- ***Blerta Gashi, Zyrtare për shqyrtimin fillestar të QDP,***
- ***znj. Bubulina Peni nga Kalkxo.com, dhe***
- ***Arkivit.***





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo

Komuna e Rahovecit

Opština Orahovac/Municipality Rahovec

Kryetari i Komunës – Presednik Opštine

Municipal Mayor



Republika e Kosovës / REPUBLIKA E KOSOVË / REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E ORAHOVAC / MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS / KABINET PRILUSIDHIA OPŠTINE / MUNICIPAL MAYOR'S CABINET

Njësia Nr./Br./No 02 (Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 3059 Nr. i faq./Br.str./No.pg 77
Data/Datum/Date 1 12 22
FAMILIJA I KRYETARIT

Në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040, nenit 59 të Ligjit Nr.04/L-042 të Prokurimit Publik, nenit 37 të Ligjit Nr.05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Prokurimin Publik, nenit 69 dhe 92 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 të datës 29.03.2017, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M

Për caktimin e komisionit për vlerësimin e ofertave

1. **Caktohet komisioni për vlerësimin e ofertave për projektin: “LOT I – Izolimi i objekteve të zjarrfiksave”, me Nr. prokurimi: 623-22-12957-5-3-5 dhe Nr. të brendshëm 623-21-4285-5-2-1/5 të datës 30.11.2022, në këtë përbërje:**
 - 1.1. Egzon Thaqi, kryesues
 - 1.2. Kosovare Gashi, anëtare
 - 1.3. Arta Kabashi, anëtare
2. Komisioni ka për detyrë të bëjë vlerësimin e ofertave për projektin “LOT I – Izolimi i objekteve të zjarrfiksave”, me Nr. prokurimi: 623-22-12957-5-3-5 dhe Nr. të brendshëm 623-21-4285-5-2-1/5 të datës 30.11.2022.
3. Obligohet komisioni që këto punë ti kryej duke u bazuar në legjislacionin në fuqi.
4. Komisioni do të fillojë punën menjëherë pas nënshkrimit të këtij vendimi dhe punët duhet të përfundojnë në një afat të arsyeshëm.
5. Vendimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

Vendimi u dërgohet:

- Anëtarëve të komisionit,
- Zyrës së Prokurimit, dhe
- Arkivit.





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac / Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



Opština Orahovac / Municipality Orahovac
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor
Nr. Fq./No. 3060 Nr. i faq/Br.str/No. pg. 77
Data/Datum/Date 1 / 12 / 22
ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Kosovës ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), Ligjit Nr. 06/L-021 për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 3/2018"), dispozitave të Rregullores MF-NR. 01/2019 për menaxhimin financiar dhe kontrollin, nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 i datës 29.03.2017, Kryetari i Komunës në Rahovec, merr këtë:

V E N D I M

Për caktimin koordinatorit të Grupit Punues për menaxhimin e rrezikut komunal

1. z. Ardian Rama, i sistemuar në punë dhe detyrat e punës Zyrtar për Financa, pranë Drejtorisë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale, **CAKTOHET**:

1.1. Koordinator i Grupit Punues për menaxhimin e rrezikut komunal.

2. Detyrat dhe përgjegjësitë e koordinatorit të Grupit Punues për menaxhimin e rrezikut komunal janë të përcaktuara me Ligjin Nr. 06/L-021 për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike dhe Rregulloren MF-NR: 01/2019 për menaxhimin financiar dhe kontrollin.
3. Obligohet i lartpërmenduri që së bashku me Grupin Punues të hartojë Listën e Rreziqeve komunale për Komunën e Rahovecit.
4. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset zyrtari i caktuar dhe drejtorët e drejtorive.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

Vendimi u dërgohet:

- z. Ardian Rama,
- Drejtorëve të drejtorive, dhe
- Arkivit.

Smajl Latifi
Kryetari i Komunës





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



Njësia Nr./Br./No 02 (Kabineti i Kryetarit të Komunës)

Nr./Br./No 3061 Nr. i faq./Br. str./No pg. 77

Data/Datum/Date 1 / 12 / 22

RAHOVEC / C. ORAOVAC

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), Ligjit Nr. 06/L-021 për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 3/2018"), dispozitave të Rregullores MF-NR. 01/2019 për menaxhimin financiar dhe kontrollin nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 të datës 29.03.2017, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M

Për caktimin e Grupit Punues për hartimin e Listës së Rreziqeve komunale

1. **Caktohet** Grupi Punues për hartimin e Listës së Rreziqeve komunale të Komunës së Rahovecit, në këtë përbërje:
 - 1.1 Fatmir Iska – Nënkryetar i Komunës, kryesues
 - 1.2 Afrim Limani – Drejtor i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, anëtar
 - 1.3 Besnik Hoti – Drejtor i Drejtorisë për Administratë, anëtar
 - 1.4 Avni Morina – Drejtor i Drejtorisë për Arsim, anëtar
 - 1.5 Përparim Krasniqi – Drejtor i Drejtorisë për Shërbime Publike, anëtar
 - 1.6 Afrim Dina – Drejtor i Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport, anëtar
 - 1.7 Erhan Morina – Drejtor i Drejtorisë për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm, anëtar
 - 1.8 Berat Duraku – Drejtor i Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, anëtar
 - 1.9 Afrim Oruqi – Drejtor i Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë, anëtar
 - 1.10 Albnor Mullaabazi – Drejtor i Drejtorisë për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit, anëtar
 - 1.11 Nora Boshnjaku – Drejtoreshë e Drejtorisë për Inspektim, anëtare
 - 1.12 Saranda Salltekeku – Drejtoreshë e Drejtorisë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale, anëtare
 - 1.13 Ruzhdi Kabashi – U.D. i Udhëheqësit të Njesisë së Auditimit, anëtar
 - 1.14 Astrit Mullabazi – U.D. i Udhëheqësit të Njesisë së Prokurimit, anëtar
 - 1.15 Ekrem Bytyqi – Udhëheqës i sektorit të buxhetit dhe financave, anëtar
 - 1.16 Admirim Durguti – Zyrtar i Drejtorisë për Arsim, anëtar
 - 1.17 Asllan Mazreku – Zyrtar në Drejtrinë për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm, anëtar
 - 1.18 Fatmir Hoti – Zyrtar i tatimit në pronë, anëtar
2. Grupi punues ka për detyrë që në bashkëpunim me koordinatorin e Grupit Punues për menaxhimin e rrezikut komunal z. Ardian Rama, të hartojë Listën e Rreziqeve komunale të Komunës së Rahovecit.
3. Obligohet Grupi Punues që të veprojë duke u bazuar në Ligjin Nr. 06/L-021 për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike dhe Rregulloren MF-NR: 01/2019 për menaxhimin financiar dhe kontrollin.

4. Grupi Punues do të fillojë punën menjëherë pas nënshkrimit të këtij vendimi dhe punët duhet të përfundojnë në një afat të arsyeshëm.
5. Obligohet koordinatori dhe kryesuesi i Grupit punues që pas përfundimit të punëve të hartojnë raport me shkrim për Kryetarin e Komunës.
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

Vendimi u dërgohet:

- ***Z. Ardian Rama – koordinatori i grupit punues,***
- ***Anëtarëve të Grupit Punues,***
- ***Arkivit***





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS / KABINET PRILSDENIKA OPŠTINE / MUNICIPAL MAYOR'S CABINET

Njësia Nr./Br./No 02 (Kabineti i Kryetarit të Komunës)

Nr./Br./No 3062 Nr. i faq./Br.str./No.pg 77

Data/Datum/Date 1 / 12 / 22

RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 35 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik dhe nenit 37 të Ligjit Nr. 05/L-068 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Prokurimin Publik, nenit 63, nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 i datës 29.03.2017, Kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

1. Miratohet kërkesa për punët shtesë dhe punë të paparapara e Menaxherit të Projektit dhe raportit të Organit Mbikëqyrës të datës: 31.10.2022, në projektin "Ndërtimi i rrugëve dhe këndit rekreativ në lagjen e komuniteteve" me Nr. të Prokurimit 623-22-7382-5-2-1 në shumën prej 5,452.00€ (pesëmijë e katërqind e pesëdhjetë e dy euro).
2. Ky vendim merret, pasi që është konstatuar nga organi mbikëqyrës dhe menaxheri i kontratës së projektit dhe verifikimit të gjendjes në terren, se projekti është në fazën përfundimtare dhe për t'u funksionalizuar është e nevojshme që të kryhen punë shtesë.
3. Obligohet Sektori i Prokurimit që t'i ndërmerr të gjitha veprimet e nevojshme për zhvillimin e procedurave sipas ligjeve dhe akteve nënligjore të aplikueshme në Republikën e Kosovës.
4. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen: Zyra e Prokurimit, Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe Menaxheri i Projektit.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

Vendimi u dërgohet:

- Zyrës së Prokurimit,
- Drejtorisë për Shërbime Publike,
- Drejtorisë për Buxhet dhe Financa,
- Menaxherit të Projektit,
- Organit Mbikëqyrës, dhe
- Arkivit.

Smaji Latifi

Kryetari i Komunës



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna Rahovec
Opština Orahovac / Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Mayor Office



REPUBLIC OF KOSOVO / REPUBLIKA E KOSOVES
MUNICIPALITY OF ORAHOVAC / OPŠTINA ORAHOVAC
Kryetari i Komunës / Presednik Opštine / Mayor Office
Njësia Nr./Pr./No 02 (Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 3063 Nr. i faq./Br.str./No.pg 78
Data/Datum/Data 1 / 12 / 22
ORAHOVAC / ORAHOVAC

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës Nr. 03/L-040 ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 i datës 29.03.2017, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M

1. **MIRATOHET** Kërkesa e Organizatës së Veteranëve të Luftës të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në Rahovec me Nr. Prot. 5329 të dt. 1.12.2022.
2. OVL - UÇK-së, i ndahen 50 (pesëdhjetë) litra naftë për zhvillimin e aktiviteteve të ndryshme të shoqatave të dala nga lufta për muajin Dhjetor, të cilat janë në plan programin e OVL – UÇK-së.
3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe Drejtoria për Administratë.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

Vendimi u dërgohet:

- OVL – UÇK-së në Rahovec,
- Drejtorisë për Buxhet dhe Financa,
- Drejtorisë për Administratë, dhe
- Arkivit.

Smajl-Letifi
[Signature]
Kryetari i Komunës



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit



Opština Orahovac/Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor

KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS / KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS
KOMUNA RAHOVEC / OPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY RAHOVEC
Njësia Nr./Br./No 02 (Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 3065 Nr. i faq./Br.str./No.pg 78
Data/Datum/Date 2 / 12 / 22
RAHOVEC / ORAHOVAC

Duke u bazuar në nenin 13 dhe nenin 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenin 3, nenin 4 paragrafi 2 pika 2.3 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 01/2018 i datës 26.06.2018 për caktimin e stafit mbështetës në komuna, nenin 5 pika 1, nenin 7 dhe nenin 10 të Rregullores për Organizimin e Brendshëm, Kompetencat dhe Përgjegjësitë e Administratës së Komunës së Rahovecit 01. Nr. 1092 datë 27.03.2015, nenin 74, nenin 81 paragrafi 1 pika 1.4, nenin 82 paragrafi 1 pika 1.2 dhe nenin 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahoveci Nr. 1005 i datës 29.03.2017, Kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për emërimin e Zyrtarit administrativ në kabinetin e Kryetarit të Komunës

1. z. Sabahajdin Cena nga Rahoveci, i lindur më 13.03.1953 dhe me Nr. Personal 1002747088, **EMËROHET:**

1.1 Zyrtar administrativ në Kabinetin e Kryetarit të Komunës së Rahovecit dhe këshilltar për kategoritë e dala nga lufta e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

2. Të drejtat detyrat dhe përgjegjësitë e Zyrtarit Administrativ përcaktohen nga Kryetari i Komunës.
3. Marrëdhënia e punës e Zyrtarit Administrativ në Kabinetin e Kryetarit të Komunës, fillon nga data 2.12.2022 dhe pushon me përfundimin e mandatit të Kryetarit të Komunës, nëse kjo marrëdhënie e punës nuk ndërpritet më herët.
4. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Zyra e Personelit dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

Me vendim të njoftohen:

- Të emëruarit,
- Drejtorisë për Buxhet dhe Financa,
- Zyrës së personelit, dhe
- Arkivit.





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo

Komuna e Rahovecit

Opština Orahovac/Municipality Rahovec

Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



Njësitë e punës No 02 (Kabineti i Kryetarit të Komunës)

Nr. Dk. No 3066 Nr. i faq/Br. str/No pg 78

Data/Date/Date 2 / 12 22

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenin 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Republikës së Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 20 paragrafi 3 i Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funkcionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, nenit 33 paragrafi 2 pika 2.3 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publik, nenit 74 dhe nenin 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 i datës 29.03.2017, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M

1. Me këtë vendim z. **Petrit Haxhijaha**, i sistemuar në punë dhe detyrat e punës Zyrtar për administrimin e teknologjisë informative pranë Drejtorisë për Administratë, **caktohet** zëvendësues i Shefit të sektorit të gjendjes civile pranë Drejtorisë për Administratë që të punojë me kompetenca të plota, deri në përfundimin e procedurave të rekrutimit dhe zgjedhjes së Shefit të sektorit të gjendjes civile pranë Drejtorisë për Administratë, sipas konkursit.
2. Të lartpërmendurit sipas pikës 1 të këtij vendimi do ti takojë kompenzimi i pagës së Shefit të sektorit të gjendjes civile pranë Drejtorisë për Administratë.
3. Vendimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

A r s y e t i m

Duke marrë parasysh se Shef i sektorit të gjendjes civile pranë Drejtorisë për Administratë z. Neki Krasniqi është transferuar në një pozitë tjetër të punës dhe me këtë rast, vendi i punës së Shefit të sektorit të gjendjes civile pranë Drejtorisë për Administratë në Komunën e Rahovecit ka mbetur i lirë (vakant).

Për këtë arsye, duke marrë parasysh vëllimin e madh të punëve dhe përgjegjësi në udhëheqjen e sektorit të gjendjes civile, pas administrimit të të gjitha provave u vendos që zëvendësues i Shefit të sektorit të gjendjes civile pranë Drejtorisë për Administratë të caktohet z. Petrit Haxhijaha, i sistemuar në punë dhe detyrat e punës Zyrtar për administrimin e teknologjisë informative pranë Drejtorisë për Administratë, deri në përfundimin e procedurave të rekrutimit dhe zgjedhjes së Shefit (udhëheqësit) të sektorit të gjendjes civile, sipas konkursit.

Andaj, bazuar në atë që u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshilla Juridike: Pala e pakënaqur me këtë vendim ka të drejtën e ankesës në afat prej 30 ditësh, nga dita e pranimit të vendimit, pranë Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Vendimi u dërgohet:

- z. **Petrit Haxhijaha**,
- **Drejtorisë për Administratë**,
- **Drejtorisë për Buxhet dhe Financa**,
- **Njësisë së Personelit, dhe**
- **Arkivit.**





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)

Nr./Br./No 3068 Nr. i faq/Br.str/No.pg 78

Data/Datum/Date 2 / 12 / 22

RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 81 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-92, nenit 61 paragrafi 61.15 i Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik Nr. A01 i datës 10.04.2019, nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 i datës 29.03.2017, Kryetari i Komunës së Rahovecit, merr këtë:

V E N D I M

Për caktimin e menaxherit të kontratës dhe mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës

1. Caktohet menaxheri i kontratës dhe mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës me titull: "Lot 4 – Ndërtimi i urës dhe kanalit të kullimit në Çifllak" me numër të kontratës 623-21-2485-5-1-1/C301 si në vijim:
 - 1.1 z. Hasan Vuqitërna i sistemuar në punë dhe detyrat e punës Zyrtar për Bujqësi pranë Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, **CAKTOHET** menaxher i kontratës sipas pikës 1 (një) të këtij vendimi.
 - 1.2 z. Berat Duraku, Drejtor i Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural **CAKTOHET** mbikëqyrës i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës sipas pikës 1 (një) të këtij vendimi.
2. Menaxheri i kontratës dhe mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës, obligohen që të bëjnë administrimin dhe menaxhimin e implementimit të kontratës në pajtim me nenin 61 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurim Publik Nr. A01, si dhe Manualët për Përdorim të Modulit për Menaxhim të Kontratës.
3. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi shfuqizohet vendimi me Nr. Prot. 02/3011/22 i datës 21.11.2022.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

Me vendim të njoftohen:

- Menaxheri i projektit,
- Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë,
- Sektori i prokurimit.
- Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, dhe
- Arkivi

Smajl Latifi

Kryetar i Komunës

Zyrtar Kryesor Administrativ





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Oraovac/Municipality of Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



Njësia Nr./Br./No 02/Kabineti i Kryetarit të Komunës

Nr./Br./No 3069 Nr. i faq./Br.str./No.pg 78

Data/Datum/Date 2 / 12 / 22

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 81 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-92, nenit 61 paragrafi 61.15 i Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik Nr. A01 i datës 10.04.2019, nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 i datës 29.03.2017, Kryetari i Komunës së Rahovecit, merr këtë:

V E N D I M

Për caktimin e menaxherit të kontratës dhe mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës

1. Caktohet menaxheri i kontratës dhe mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës me titull: "Rregullimi i ngrohjes qendrore në SHFMU "Rudolf Walther" në Dejnë" me numër të kontratës 623-22-12831-5-3-6/C439, si në vijim:
 - 1.1 z. Jetmir Ukaj, i sistemuar në punë dhe detyrat e punës Zyrtar teknik i ndërtimtarisë, pranë Drejtorisë për Administratë, **CAKTOHET** menaxher i kontratës sipas pikës 1 (një) të këtij vendimi.
 - 1.2 z. Avni Morina, Drejtor i Drejtorisë për Arsim **CAKTOHET** mbikëqyrës i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës sipas pikës 1 (një) të këtij vendimi.
2. Menaxheri i kontratës dhe mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës, obligohen që të bëjnë administrimin dhe menaxhimin e implementimit të kontratës në pajtim me nenin 61 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurim Publik Nr. A01, si dhe Manualët për Përdorim të Modullit për Menaxhim të Kontratës.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

Me vendim të njoftohen:

- Menaxheri i projektit,
- Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë,
- Sektori i prokurimit.
- Drejtoria për Arsim, dhe
- Arkivi

Smajl Latifi
Kryetar i Komunës
Zyrtar Kryesor Administrativ



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



Njësi Nr./B./No 02/Kabineti i Kryetarit të Komunës)

Nr./Br./No 3070 Nr. i faq./Br./str./No. pg 78

Data/Datum/Datë 2 / 12 / 22

RAHOVEC / OROHOVAC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), rishpalljes së konkursit publik për dizajnimin e titujve të nderit, dekoratave dhe çmimeve nga Komuna e Rahovecit të shpallur nga Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport me Nr. Prot. 148 të datës 21.11.2022, nenit 74 dhe 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 i datës 29.03.2017, Kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për caktimin e komisionit për shqyrtimin dhe vlerësimin e aplikacioneve

1. **Caktohet** komisioni për shqyrtimin dhe vlerësimin e aplikacioneve sipas konkursit publik të rishpallur për dizajnimin e titujve të nderit, dekoratave dhe çmimeve nga Komuna e Rahovecit të shpallur nga Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport me Nr. Prot. 148 të datës 21.11.2022, në këtë përbërje:
 - 1.1 Shadat Ukaj, kryesues
 - 1.2 Ruzhdi Hoxha, anëtar
 - 1.3 Edona Bytyqi, anëtare
 - 1.4 Qamil Shtavica, anëtar
 - 1.5 Mërgime Hoti, anëtare
2. Komisioni ka për detyrë që të bëjë shqyrtimin dhe vlerësimin e aplikacioneve sipas rishpalljes së konkursit publik për dizajnimin e titujve të nderit, dekoratave dhe çmimeve nga Komuna e Rahovecit të shpallur nga Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport me Nr. Prot. 148 të datës 21.11.2022.
3. Obligohet komisioni që këto punë ti kryejë duke u bazuar në Rregulloren për dhënien e titujve të nderit, dekoratave dhe çmimeve nga Komuna e Rahovecit me Nr. Prot. 01 Nr. 327/22 të datës 31.05.2022 dhe rishpalljen e konkursit publik për dizajnimin e titujve të nderit, dekoratave dhe çmimeve nga Komuna e Rahovecit të shpallur nga Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport me Nr. Prot. 144 të datës 21.10.2022.
4. Obligohet komisioni që pas përfundimit të punëve të hartoj raport me shkrim për Kryetarin e Komunës dhe Drejtorinë për Kulturë, Rini dhe Sport.
5. Komisioni do të filloj punën menjëherë pas nënshkrimit të këtij vendimi dhe punët duhet të përfundojnë në një afat të arsyeshëm.
6. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Vendimi u dërgohet:

- Anëtarëve të komisionit,
- Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport, dhe
- Arkivit.





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna Rahovec



Opština Orahovac / Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – President of the Municipality – Mayor Office

KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS, KABINET PREDSEDNIKA OPŠTINE, MUNICIPAL MAYOR'S COUNCIL

Njësia Nr./Br./No. 02 (Kabineti i Kryetarit të Komunës)

Nr./Br./No. 3071 Nr. ifaq./Br.st./No.pz. 78

Data/Datum/Date 2 / 12 / 22

RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008"), Vendimin e Kuvendit të Komunës së Rahovecit me Nr. Prot. 1427 të datës 30.04.2019, nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 i datës 29.03.2017 dhe Konkursit për krijimtari letrare (për të rritur), të shpallur nga Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport me Nr. Prot. 147 të dt. 07.11.2022, Kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për caktimin e jurisë profesionale për vlerësimin e punimeve dhe përzgjedhjen e krijimtarisë më të mirë letrare për dhënien e çmimit letrar "Sulejman Krasniqi"

1. Caktohet juria profesionale për vlerësimin e punimeve dhe përzgjedhjen e krijimtarisë më të mirë letrare për dhënien e çmimit letrar "Sulejman Krasniqi", në këtë përbërje:
 - 1.1. Sokol Gashi, kryesues
 - 1.2. Besim Muhadri, anëtar
 - 1.3. Leonita Parallangaj, anëtare
2. Juria profesionale ka për detyrë që të bëjë shqyrtimin e të gjitha punimeve dhe krijimtarive letrare dhe përzgjedhjen e krijimtarisë më të mirë letrare dhe propozimin për krijimtarinë më të mirë letrare për dhënien e çmimit letrar "Sulejman Krasniqi".
3. Obligohet juria profesionale që këto punë ti kryejë duke u bazuar në Konkursin për krijimtari letrare me Nr. Prot. 147 të dt. 07.11.2022 të shpallur nga Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport si dhe ligjet dhe aktet nënligjore në fuqi.
4. Juria profesionale do të filloj punën menjëherë pas nënshkrimit të këtij vendimi dhe punët duhet të përfundojnë në një afat të arsyeshëm.
5. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen anëtarët e jurisë dhe Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport.
6. Vendimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

Vendimi u dërgohet:

- Anëtarëve të jurisë,
- Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport, dhe
- Arkivit.





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



REPUBLICA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E RAHOVECIT / OPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY RAHOVEC

KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS / KABINETI PRESIDENTIAL OPŠTINE / MUNICIPAL MAYOR'S CABINET

Njësia Nr./Str./No 02 (Kabineti i Kryetarit të Komunës)

Nr./Br./No 3073 Nr. ifaq/Br.str/No.pg 79

Data/Datum/Date 2 / 12 / 22

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenin 58 të Ligjit Nr. 03/L040 për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës, ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 5 pika 2, nenit 17 dhe nenit 29 të Rregullores për Organizimin e Brendshëm, Kompetencat dhe Përgjegjësitë e Administratës së Komunës së Rahovecit 01. Nr. 1092 datë 27.03.2015, nenit 74, nenit 81 paragrafi 1.1, nenit 84 paragrafi 1, nenit 85 paragrafi 1 pika 1.12 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 i datës 29.03.2017, Kryetari i Komunës së Rahovecit, merr këtë:

V E N D I M

Për emërimin e Drejtores së Drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim

1. **znjsh. Besmire Bytyqi** nga fsh. Opterushë, Komuna e Rahovecit, me Nr. Personal 1231887845 dhe me përgatitje profesionale Juriste e diplomuar në Universitetin "Ukshin Hoti" në Prizren, emërohet:

1.1 Drejtore e Drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim.

2. Detyrat dhe përgjegjësitë të drejtores së drejtorisë janë të përcaktuara me Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës Nr. 03/L-040, Statutin e Komunës së Rahovecit Nr. 1005 i datës 29.03.2017 dhe Rregulloren për Organizimin e Brendshëm, Kompetencat dhe Përgjegjësitë e Administratës së Komunës së Rahovecit: 01. Nr. 1092 e datës 27.03.2015.
3. Ky emërim fillon nga data **2.12.2022** dhe përfundon me përfundimin e mandatit të Kryetarit të Komunës, nëse kjo marrëdhënie e punës nuk ndërpritet më herët.
4. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Zyra e Personelit dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

Vendimi u dërgohet:

- Të emëruarit,
- Drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim,
- Drejtorisë për Buxhet dhe Financa,
- Zyrës së personelit, dhe
- Arkivit.

Snajl Latifi
Kryetari i Komunës





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo

Komuna e Rahovecit

Opština Orahovac / Municipality Rahovec

Kryetari i Komunës – Prešednik Opštine

Municipal Mayor

Mësia Nr./Br./No 02 (Kabineti i Kryetari të Komunës)

Nr. ifaq/Br.str/No.pz 79

Data/Date 5 / 12 / 22

RAHOVEC / ORAHOVAC



Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008"), nenit 2, nenit 18 dhe nenit 19 të Rregullores MF-Nr.02/2013 Për Menaxhimin e Pasurisë jo Financiare në Organizatat Buxhetore, nenit 5 të Rregullores së Komunës së Komunës së Rahovecit për menaxhimin e pasurisë jo financiare dhe inventari i përdorshëm i komunës 01 Nr. 290/22 të datës 30.03.2022, nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 i datës 29.03.2017, Kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për caktimin e komisionit për inventarizimin e pasurive jo financiare dhe financiare

1. **Caktohet komisioni për inventarizimin e pasurive jo financiare dhe financiare në Komunën e Rahovecit, në këtë përbërje:**
 - 1.1 Veton Mustafa, kryesues
 - 1.2 Admirim Durguti, anëtar
 - 1.3 Tefik Krasniqi, anëtar
2. Komisioni ka për detyrë që të bëjë inventarizimin e pasurive jo financiare dhe financiare të Komunës së Rahovecit duke u bazuar në Rregulloren MF-Nr.02/2013 Për Menaxhimin e Pasurisë jo Financiare në Organizatat Buxhetore dhe Rregulloren e Komunës së Komunës së Rahovecit për menaxhimin e pasurisë jo financiare dhe inventari i përdorshëm i komunës 01 Nr. 290/22 të datës 30.03.2022.
3. Komisioni do të fillojë punën menjëherë pas nënshkrimit të këtij vendimi dhe punët duhet të përfundojnë deri me datë 15.12.2022.
4. Mandati i komisionit për inventarizimin e pasurive jo financiare dhe financiare është dy (2) vjeçar.
5. Obligohet komisioni që pas përfundimit të punëve të hartoj raport me shkrim për Kryetarin e Komunës dhe Drejtorinë për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm.
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

Vendimi u dërgohet:

- Anëtarëve të komisionit,
- Drejtorisë për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm,
- Drejtorisë për Administratë, dhe
- Arkivit.

REPUBLIKA E KOSOVES
KOMUNA E RAHOVECI
KRYETARI I KOMUNES
Smail Latifi
Kryetari i Komunës



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac / Municipality of Orahovac
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



Njësia Nr./Br./No. 02/Kabineti i Kryetarit të Komunës
Nr./Br./No. 3083 Nr. i faq./Br.str./No.pg. 80
Data/Datum/Date 6 / 12 / 22
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040 (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008), nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 i datës 29.03.2017 dhe nenit 4 paragrafi 4 dhe nenit 21 paragrafi 2 pika 2.1 dhe 2.2 i Rregullores për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve me Nr.1427 të datës 28.04.2017, Kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

1. **MIRATOHET** kërkesa [redacted] Komuna e Rahovecit me Nr. Protokolit 5112, të dt. 9.11.2022 për ndihmë financiare prej 500.00€ (pesëqind euro) për mbulimin e shpenzimeve të mjekimit dhe blerjen e barnave për tretman të sëmundjes.
2. Mjetet sigurohen nga kodi i subvencioneve të Zyrës së Kryetarit dhe do të transferohen në [redacted]
3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
4. Vendimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

A r s y e t i m

[redacted] vuan nga sëmundja e rëndë, e cila ka nevojë për tretman të vazhdueshëm për shërimin e saj. Shërimi i sëmundjes për të është tejet i kushtueshëm dhe ka kosto të lartë financiare të papërballueshme për të, pasi që asnjë anëtar i familjes nuk është në marrëdhënie pune të vazhdueshme. Andaj, duke marrë parasysh gjendjen e rëndë shëndetësore dhe financiare të të lartpërmendurit, pasi që shpenzimet e mjekimit dhe të blerjes së barnave për shërimin kanë kosto të lartë financiare, ai e ka të vështirë mbulimin e shpenzimeve elementare për jetesë dhe blerjen e barnave për shërimin e sëmundjes, kështu që është e domosdoshme ndihma për tejkalimin e kësaj gjendjeje. Andaj, duke marrë parasysh atë që u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi

Me vendim të njoftohen:

- [redacted]
- **Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale,**
- **Drejtoria për Buxhet dhe Financa, dhe**
- **Arkivi.**





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac / Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



Nr./Br./No. 02 (Kabineti i Kryetarit të Komunës)

Nr./Br./No. 3084 Nr. i faq./Br.str./No. pg. 80

Data/Datum/Date 6 / 12 / 22

RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040 (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008), nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 i datës 29.03.2017 dhe nenit 4 paragrafi 4 dhe nenit 21 paragrafi 2 pika 2.1 dhe 2.2 i Rregullores për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve me Nr.1427 të datës 28.04.2017, Kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

1. **MIRATOHET** [redacted] nga Rahoveci me Nr. Protokolit 5335, të dt. 2.12.2022 për ndihmë financiare prej 200.00€ (dyqind euro) për mbulimin e shpenzimeve të mjekimit dhe blerjen e barnave për tretman të sëmundjes.
2. Mjetet sigurohen nga kodi i subvencioneve të Zyrës së Kryetarit.
3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
4. Vendimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

Arsyetim

[redacted], vuan nga sëmundja e rëndë, e cila ka nevojë për tretman të vazhdueshëm për shërimin e saj. Shërimi i sëmundjes për të është tejet i kushtueshëm dhe ka kosto të lartë financiare të papërbalueshme për të, pasi që asnjë anëtar i familjes nuk është në marrëdhënie pune të vazhdueshme. Andaj, duke marrë parasysh gjendjen e rëndë shëndetësore dhe financiare të të lartpërmendurit, pasi që shpenzimet e mjekimit dhe të blerjes së barnave për shërimin kanë kosto të lartë financiare, ai e ka të vështirë mbulimin e shpenzimeve elementare për jetesë dhe blerjen e barnave për shërimin e sëmundjes, kështu që është e domosdoshme ndihma për tejkalimin e kësaj gjendjeje.

Andaj, duke marrë parasysh atë që u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi

Me vendim të njoftohen:

- [redacted]
- Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale,
- Drejtoria për Buxhet dhe Financa, dhe
- Arkivi.





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo



Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac / Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor

Opština Orahovac / Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor
Dokumenti Nr. 02 (Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./No. 3085 Nr. i faq./Br.str./No. pg. 80
Data/Datum/Date 6 / 12 / 22
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 të datës 29.03.2017, nenit 2.5 të Memorandumit të Bashkëpunimit të lidhur në mes të Drejtorisë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale dhe Shoqatës së të Drejtave të Pacientëve Nr. 1/2022 i datës 01.07.2022, Rekomandimit të Komisionit për përzgjedhjen e anëtarëve të këshillit të pacientëve të cilët kanë aplikuar sipas Ftesës publike për aplikim të shpallur nga Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale Nr. 315 të datës 6.9.2022, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M

Për themelimin e Këshillit të Pacientëve

- Me këtë vendim themelohet Këshilli i Pacientëve në Komunën e Rahovecit i përbërë nga 5 (pesë) anëtarë, duke u bazuar në rekomandimin e komisionit përzgjedhës pas përfundimit të procedurave konkurruese, në këtë përbërje:
 - 1.1.Anduena Shtavica, anëtare
 - 1.2.Shemsedin Popaj, anëtar
 - 1.3.Selman Shtavica, anëtar
 - 1.4.Egzon Hamza, anëtar
 - 1.5.Floriana Rama, anëtare
- Detyrat dhe përgjegjësitë e Këshillit të Pacientëve janë të përcaktuara në Rregulloren për Themelimin dhe Funksionimin e Këshillave të Pacientëve dhe Kodin e Etikës së Këshillave.
- Obligohet Këshilli që me konsensus të brendshëm të anëtarëve të përzgjedh kryesuesin/en e Këshillit dhe procesmbajtësin/en e Këshillit.
- Mandati i anëtarëve të Këshillit të Pacientëve është 3 (tre) vjeçar.
- Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen anëtarët e këshillit të pacientëve.
- Vendimi hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

Me vendim të njoftohen:

- Anëtarët e Këshillit të Pacienteve,
- Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale,
- QKMF "Dr Fahredin Hoti" në Rahovec, dhe
- Arkivi.

REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E RAHOVECIT
KRYETARI I KOMUNËS
Smajl Latifi
Kryetari i Komunës



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo

Komuna e Rahovecit

Opština Orahovac/Municipality Rahovec

Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



REPUBLICA E KOSOVES / REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA RAHOVEC / OPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS / KABINET PRISIEDNIKA OPŠTINE / MUNICIPAL MAYOR CABINET

Njësia Nr./Br./No 02 (Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 3091 Nr. i fag./Br.str./No.pg 20
Ditë/Datum/Date 8.12.22
Lokale të Kosovës / Nr.03/L-040, nenit 40
RAHOVEC / ORAHOVAC
3 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr. 05/L-031 të datës 25.05.2016, nenit 74 dhe 92 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 të datës 29.03.2017, Kryetari i Komunës, merr këtë:

Në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës / Nr.03/L-040, nenit 40 paragrafi 2 të Ligjit Nr.04/L-175 nenit 53 paragrafit 3 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr. 05/L-031 të datës 25.05.2016, nenit 74 dhe 92 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 të datës 29.03.2017, Kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

PLOTËSIMI DHE NDRYSHIMI I VENDIMIT ME NR. 2617, TË DATËS 19.8.2022

- Me këtë vendim plotësohet dhe ndryshohet vendimi Nr.2617, i datës 19.8.2022 për formimin e Komisionit për shqyrtimin e Ankesave të drejtuara kundër akteve dhe veprimeve procedurale të Drejtorisë për Punë Inspektuese, me të cilin anëtari i komisionit Arben Gashi zëvendësohet me Alban Gashi prandaj komisioni do të jetë në këtë përbërje:
 - 1.1. Valmir Gashi , kryesues
 - 1.2 Alban Gashi , anëtar
 - 1.3 Hasan Eminazëri, anëtar
 - 1.4 Malsor Orlati , anëtar
 - 1.5 Ivana Mojsiq , anëtare
- Komisioni ka për detyrë që të bëjë shqyrtimin dhe të vendos për Ankesat, aktet dhe veprimet të ndryshme procedurale të Drejtorisë për Punë Inspektuese (për inspektorin e mjedisit, ujrave, natyrës, planifikimit hapsinor dhe ndërtimit) .
- Obligohet komisioni që këto punë t'i kryej duke u bazuar në legjislacionin në fuqi .
- Komisioni do të fillojë punën menjëherë pas nënshkrimit të këtij vendimi dhe punët duhet të përfundojnë në një afat të arsyeshëm .
- Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Vendimi u dërgohet :

- Anëtarëve të komisionit,
- Zyrës së Prokurimit,
- Arkivit.





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo



Komuna Rahovec
Opština Orahovac / Municipality Rahovec

Kryetari i Komunës – President of the Municipality – Mayor Office

REPUBLIC OF KOSOVO
MUNICIPALITY OF ORAHOVAC / RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS / KABINET PRESIDENTIA OPŠTINE / MUNICIPAL MAYOR'S CABINET

Njësia Nr./Br./No 02 (Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 3093 Nr. i faq./Br.str./No.pg 81
Data/Datum/Date 8 / 12 / 22
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës Nr. 03/L040, (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, 28/2008), nenit 63, nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës Nr. 1005 i datës 29.03.2017, nenit 4 paragrafi 4, neni 8 paragrafi 5 dhe neni 8, nenit 11 dhe nenit 19 të Rregullores për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve Nr. 1427 të datës 28.04.2017, kërkesës së Drejtorit për DBPZHR-së dhe procesverbalit të Komisionit Komunal për vlerësimin e dëmit në pasllam 11 Nr.-580/02-0050982/22 të datës 14.11.2022, Kryetari i Komunës, merr këtë :

V E N D I M

Për ndarje të subvencioneve për ndihma momentale

1. **Miratohet** kërkesa e Nehat Haxhimustafa nga Rahoveci me nr. prot.5285, të dt. 24.11.2022, dhe i ndahen mjetet materiale për shpërblimin e dëmit të shkaktuar nga zjarri në vlerë prej 950 euro (nëntëqind e pesëdhjetë euro).
2. Mjetet sigurohen nga kodi i subvencioneve të Zyrës së Kryetarit
3. Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

U dërgohet :

- z. Nehat Haxhimustafa,
- Drejtorisë për Buxhet dhe Financa,
- Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural dhe
- Arkivit.





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PRESEDNIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET

Njësia Nr./Br./No 02 (Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 3094 Nr. i faq./Br.str./No.pg 81
Data/Datum/Date 8 / 12 / 22
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008”) dhe neneve 74 dhe 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 i datës 29.03.2017, Kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për caktimin e komisionit për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga prerja e pyjeve në territorin e komunës së Rahovecit

1. **Caktohet komisioni për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga prerja e pyjeve sipas kërkesës me Nr. Prot. 5398, të datës 7.12.2022, në këtë përbërje:**
 - 1.1. Ilvi Durguti, kryesues
 - 1.2. Zamir Haxhibeqiri, anëtar
 - 1.3. Milazim Elshani, anëtar
2. Komisioni ka për detyrë që të konstatoj dhe të bëjë vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga prerja e pyjeve në territorin e komunës së Rahovecit, duke u bazuar në kërkesën me Nr. Prot. 5398, të datës: 07.12.2022.
3. Obligohet komisioni që këto punë t'i kryej duke u bazuar në legjislacionin aktual në fuqi.
4. Komisioni do të fillojë punën menjëherë pas nënshkrimit të këtij vendimi dhe punët duhet të përfundojnë në një afat të arsyeshëm.
5. Komisioni do të hartoj raport me shkrim për Kryetarin e Komunës dhe Drejtorinë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural.
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

Vendimi u dërgohet:

- Anëtarëve të komisionit,
- DBPZHR dhe
- Arkivët.





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo



Komuna e Rahovecit

Opština Orahovac / Municipality Rahovec

Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor

KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS
KABINET PRESEDNIKA OPŠTINE
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS
KABINET PRESEDNIKA OPŠTINE
Njësia No/Br/No 02 (Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br/No 3095 Nr. i faq/Br.str/No.pg 81
Data/Datum/Date 8 / 12 / 22
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040, (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008), nenit 4 paragrafi 4 dhe nenit 21 të Rregullores për ndarjen e subvencioneve me Nr.1427 të datës 28.04.2017, dhe neneve 74 dhe 92 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 i datës 29.03.2017, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M

1. **MIRATOHET** kërkesa e **Qemajl Krasniqit** nga Rahoveci, me Nr.5399, të dt.08.12.2022 për përkrahjen financiare në vlerë prej **950.00 € (Nëntëqind e pesëdhjetë euro)** për mbulimin e shpenzimeve për botimin e monografisë **“Deri në frymën e fundit”** kushtuar dëshmorit **Skender Gashi** nga fshati Sopniq, i cili ka qenë epror i UÇK-së dhe i TMK – së.
2. Mjetet do të sigurohen nga Kodi i subvencioneve të zyrës së Kryetarit të Komunës.
3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
4. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit

U dërgohet :

- **Qemajl Krasniqit nga Rahoveci,**
- **Drejtorisë për Buxhet dhe Financa,**
- **Arkivi.**





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



REPUBLICA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E RAHOVEC / OPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS / KABINET PRIDSEDIJA OPŠTINE / MUNICIPAL MAYOR CABINET

Njësia Nr./Br./No 02 (Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 3106 Nr. i faq./Br.str./No.pg 82
Data/Datum/Date 9 / 12 / 22
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 81 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-92, nenit 61 paragrafi 61.15 i Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik Nr. A01 i datës 10.04.2019, nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 i datës 29.03.2017, Kryetari i Komunës së Rahovecit, merr këtë:

V E N D I M

Për caktimin e menaxherit të kontratës dhe mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës

1. Caktohet menaxheri i kontratës dhe mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës me titull: "Renovime në SHFMU "Bekim Sylka" në Rahovec" me numër të kontratës 623-22-9042-5-2-1/C442, si në vijim:
 - 1.1 z. Jetmir Ukaj, i sistemuar në punë dhe detyrat e punës Zyrtar teknik i ndërtimtarisë, pranë Drejtorisë për Administratë, **CAKTOHET** menaxher i kontratës sipas pikës 1 (një) të këtij vendimi.
 - 1.2 z. Avni Morina, Drejtor i Drejtorisë për Arsim **CAKTOHET** mbikëqyrës i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës sipas pikës 1 (një) të këtij vendimi.
2. Menaxheri i kontratës dhe mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës, obligohen që të bëjnë administrimin dhe menaxhimin e implementimit të kontratës në pajtim me nenin 61 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurim Publik Nr. A01, si dhe Manualët për Përdorim të Modullit për Menaxhim të Kontratës.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

Me vendim të njoftohen:

- Menaxheri i projektit,
- Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë,
- Sektori i prokurimit.
- Drejtorja për Arsim, dhe
- Arkivi





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec



Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor

KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PREDSLODA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET

Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Tr./No 8107 Nr. i faq./Br.str./No pg 82
Data/Datum/Date 5 / 12 / 22
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 81 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-92, nenit 61 paragrafi 61.15 i Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik Nr. A01 i datës 10.04.2019, nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 i datës 29.03.2017, Kryetari i Komunës së Rahovecit, merr këtë:

V E N D I M

Për caktimin e menaxherit të kontratës dhe mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës

1. Caktohet menaxheri i kontratës dhe mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës me titull: "Ndërtimi i lokaleve afariste zejtare në Rahovec" me numër të kontratës 623-22-12234-5-2-1/C444, si në vijim:
 - 1.1 z. Jetmir Ukaj, i sistemuar në punë dhe detyrat e punës Zyrtar teknik i ndërtimtarisë, pranë Drejtorisë për Administratë, **CAKTOHET** menaxher i kontratës sipas pikës 1 (një) të këtij vendimi.
 - 1.2 z. Erhan Morina, Drejtor i Drejtorisë për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm, **CAKTOHET** mbikëqyrës i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës sipas pikës 1 (një) të këtij vendimi.
2. Menaxheri i kontratës dhe mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës, obligohen që të bëjnë administrimin dhe menaxhimin e implementimit të kontratës në pajtim me nenin 61 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurim Publik Nr. A01, si dhe Manualët për Përdorim të Modulit për Menaxhim të Kontratës.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

Me vendim të njoftohen:

- Menaxheri i projektit,
- Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë,
- Sektori i Prokurimit,
- Drejtoria për Arsim, dhe
- Arkivi.


Smajl Latifi
Kryetari i Komunës
Zyrtar Kryesor Administrativ



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit



Opština Orahovac/Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor

REPUBLICA E KOSOVES / REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E RAHOVECI / OPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNES / KABINETI PRESEDNIKUT OPŠTINE / MUNICIPAL MAYOR'S COUNCIL

Njësia Nr./Br./No 02 (Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 3108 Nr. i fto./Bashk./No. 82
Data/Date/Date 9 / 12 / 22
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 81 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-92, nenit 61 paragrafi 61.15 i Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik Nr. A01 i datës 10.04.2019, nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 i datës 29.03.2017, Kryetari i Komunës së Rahovecit, merr këtë:

V E N D I M

Për caktimin e menaxherit të kontratës dhe mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës

1. Caktohet menaxheri i kontratës dhe mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës me titull: "Riparimi i nyjeve sanitare në SHFMU "Sapniqi" në Sapniq - ritenderim" me numër të kontratës 623-22-10958-5-3-6/C437, si në vijim:
 - 1.1 Z. Sokol Thaqi, i sistemuar në punë dhe detyrat e punës Koordinator i projektit "Ekipi Rajonal për Projekte Komunale (ERPK)", sipas kontratës së AZHR-së, **CAKTOHET** menaxher i kontratës sipas pikës 1 (një) të këtij vendimi.
 - 1.2 z. Avni Morina, Drejtor i Drejtorisë për Arsim, **CAKTOHET** mbikëqyrës i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës sipas pikës 1 (një) të këtij vendimi.
2. Menaxheri i kontratës dhe mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës, obligohen që të bëjnë administrimin dhe menaxhimin e implementimit të kontratës në pajtim me nenin 61 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurim Publik Nr. A01, si dhe Manualin për Përdorim të Modullit për Menaxhim të Kontratës.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

Me vendim të njoftohen:

- Menaxheri i projektit,
- Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë,
- Sektori i prokurimit,
- Drejtorja për Arsim, dhe
- Arkivi





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



Njësia Nr./B./No. 02/Kabineti i Kryetarit të Komunës
Nr./B./No. 3109 Nr. i fletës/Br./No. p. 22
Data/Datum/Date 3 12 / 22
RAHOVECI / ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Kosovës (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008”), nenit 81 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-92, nenit 61 paragrafi 61.15 i Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik Nr. A01 i datës 10.04.2019, nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 i datës 29.03.2017, Kryetari i Komunës së Rahovecit, merr këtë:

V E N D I M

Për caktimin e menaxherit të kontratës dhe mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës

1. Caktohet menaxheri i kontratës dhe mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës me titull: “Furnizim me rekuizita për nevojat e Komunës së Rahovecit” me numër të kontratës 623-22-12680-1-2-1/C440, si në vijim:
 - 1.1 z. Muharem Morina, i sistemuar në punë dhe detyrat e punës Zyrtar për Rini, pranë Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport, **CAKTOHET** menaxher i kontratës sipas pikës 1 (një) të këtij vendimi.
 - 1.2 z. Afrim Dina, Drejtor i Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport, **CAKTOHET** mbikëqyrës i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës sipas pikës 1 (një) të këtij vendimi.
2. Menaxheri i kontratës dhe mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës, obligohen që të bëjnë administrimin dhe menaxhimin e implementimit të kontratës në pajtim me nenin 61 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurim Publik Nr. A01, si dhe Manualin për Përdorim të Modullit për Menaxhim të Kontratës.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

Me vendim të njoftohen:

- Menaxheri i projektit,
- Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë,
- Sektori i prokurimit.
- Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, dhe
- Arkivi

Smajl Latifi
Kryetar i Komunës
Zyrtar Kryesor Administrativ



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo

Komuna e Rahovecit

Opština Orahovac/Municipality Rahovec

Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



Njësia Nr./Br./No 02 (Kabineti i Kryetarit të Komunës)

Nr./Br./No 3110 Nr. i faq./Br. str./No pg 82

Data/Datum/Date 9 12 22

RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 81 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-92, nenit 61 paragrafi 61.15 i Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik Nr. A01 i datës 10.04.2019, nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 i datës 29.03.2017, Kryetari i Komunës së Rahovecit, merr këtë:

V E N D I M

Për caktimin e menaxherit të kontratës dhe mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës

1. Caktohet menaxheri i kontratës dhe mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës me titull: "Ndërtimi i objektit të SHFMU "Hamëz Thaqi" në Xërxë" me numër të kontratës 623-22-7571-5-1-1/C426, si në vijim:
 - 1.1 znjsh. Diellza Çanta, i sistemuar në punë dhe detyrat e punës Zyrtare për eficiencë të energjisë, pranë Drejtorisë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale, **CAKTOHET** menaxher i kontratës sipas pikës 1 (një) të këtij vendimi.
 - 1.2 z. Avni Morina, Drejtor i Drejtorisë për Arsim, **CAKTOHET** mbikëqyrës i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës sipas pikës 1 (një) të këtij vendimi.
2. Menaxheri i kontratës dhe mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës, obligohen që të bëjnë administrimin dhe menaxhimin e implementimit të kontratës në pajtim me nenin 61 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurim Publik Nr. A01, si dhe Manualët për Përdorim të Modulit për Menaxhim të Kontratës.
3. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi shfuqizohet vendimi me Nr. Prot. 02/3008/22 i datës 21.11.2022.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

Me vendim të njoftohen:

- Menaxheri i projektit,
- Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë,
- Sektori i Prokurimit,
- Drejtoria për Arsim, dhe
- Arkivi.



Smajl Latifi

Kryetari i Komunës
Zyrtar Kryesor Administrativ



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



REPUBLICA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA RAHOVEC / OPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY RAHOVEC

KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS / KABINET PRESEDNIKA OPŠTINE / MUNICIPAL MAYOR CABINET

Njësia Nr./Br./No 02 (Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 3113 Nr. i faq./Br.sht./No.pg 83
Data/Datum/Date 9 / 12 / 22
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr. 03/L-040-për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008") dhe neneve 74 dhe 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 i datës 29.03.2017, Kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për caktimin e komisionit për vlerësimin e dëmeve

1. **Caktohet** komisioni për vlerësimin e dëmeve sipas kërkesës me Nr. Prot. 5441 të datës 8.12.2022, në këtë përbërje:
 - 1.1. Ilvi Durguti, kryesues
 - 1.2. Zamir Haxhibeqiri, anëtar
 - 1.3. Milazim Elshani, anëtar
2. Komisioni ka për detyrë që të konstatoj dhe të bëjë vlerësimin e dëmit të prerjes së pyllit, duke u bazuar në kërkesën me Nr. Prot. 5441 të datës 8.12.2022.
3. Obligohet komisioni që këto punë ti kryejë duke u bazuar në legjislacionin aktual në fuqi.
4. Komisioni do të fillojë punën menjëherë pas nënshkrimit të këtij vendimi dhe punët duhet të përfundojnë në një afat të arsyeshëm.
5. Komisioni do të hartoj raport me shkrim për Kryetarin e Komunës dhe Drejtorinë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural.
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

Vendimi u dërgohet:

- Anëtarëve të komisionit,
- DBPZHR, dhe
- Arkivit.





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit

Opština Orahovac / Municipality Rahovec

Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)

Nr./Br./No 3115 Nr. i faq./Br.str./No.pg 83

Data/Datum/Date 9 / 12 / 22

RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale në Kosovë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenin 2 dhe 16 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publik ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 8/2019"), dispozitave të Ligjit Nr. 03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civilë dhe dispozitave të Rregullores Nr. 33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të Tjera të Nëpunësve Civil, nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005, i datës: 29.03.2017, Kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për refuzimin e kërkesës për pagesën e shpërblimit të përvjetorit (jubile)

1. **REFUZOHET si e pabazuar** kërkesa e z. Luan Sharku nga Rahoveci, me Nr. Prot. 5130 të dt. 10.11.2022, i sistemuar në punë dhe detyrat e punës Mirëmbajtës i objekteve të komunës - Shtëpiakë, pranë Drejtorisë për Administratë në Komunën e Rahovecit.
2. Refuzimi sipas pikës 1 të këtij vendimi bëhet për shkak se i lartpërmenduri nuk i përmbush kushtet që të jetë përfitues i shpërblimit të përvjetorit (jubile).
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

A r s y e t i m

Më datë 10.11.2022 z. Luan Sharku ka parashtruar kërkesë për kompensimin e pagesës jubilarë për punën e pandërprerë në shërbimin civil nga data 15.03.2002 dhe në vazhdimësi deri në ditët e sotme si Mirëmbajtës i objekteve të komunës - Shtëpiakë, pranë Drejtorisë për Administratë në Komunën e Rahovecit.

Pas shkresës së pranuar nga Njësia e Personelit me datë 29.09.2020, në të cilën shihet se punonjësi z. Luan Sharku nga Rahoveci nuk i takon kategorisë së shërbyesve civil, ashtu siç përshkruhet edhe në kontratën e marrëdhënies së punës së të lartpërmendurit, pasi që i njëjti sipas kontratës me Nr. Prot. 4300-7 të datës 31.12.2015 pozita e tij nuk është aprovuar si pozitë e shërbimit civil nga katalogu i MAP-së.

Provë: Kontrata me Nr. Prot. 4300-7 të datës 31.12.2015

Andaj, duke marrë parasysh se Ligji për Pagat e Nëpunësve Civil Nr. 03/L-147 si dhe Rregullorja Nr. 33/2012 çër Shtesat në Pagë dhe Kompensime të Tjera të Nëpunësve Civil parasheh shpërblimin e përvjetorit (jubile) për kategorinë e nëpunësve civil të cilat janë në marrëdhënie të punës në Shërbimin Civil, të lartpërmendurit, nuk i takon shpërblimi i përvjetorit (jubile) sipas dispozitave të Ligjit dhe Rregullores së lartcekur si dhe duke u bazuar në kontratën e punës së të lartpërmendurit.

Andaj, pas shqyrtimit të kërkesës, në bazë të dispozitave ligjore në fuqi, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi, pala e pakënaqur, mund të parashtojë ankesë pranë organeve kompetente, në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit të të njëjtit.

Vendimi u dërgohet:

- z. Luan Sharku,
- Njesisë së Personelit,
- Arkivit.





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac / Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



KOMUNITA E RAHOVECIT / OPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY RAHOVEC

KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS / KABINET PRÉSDHËJA OPŠTINE / MUNICIPAL MAYOR CABINET

Njësia Nr./Br./No 02 (Kabineti i Kryetarit të Komunës)

Nr./Br./No 316 Nr. i faq./Br.str./No.pg 83

Data/Datum/Date 9 / 12 / 22

RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale në Kosovë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenin 2 dhe 16 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publik ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 8/2019"), dispozitave të Ligjit Nr. 03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civilë dhe dispozitave të Rregullores Nr. 33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të Tjera të Nëpunësve Civil, nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005, i datës: 29.03.2017, Kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për refuzimin e kërkesës për pagesën e shpërblimit të përvjetorit (jubile)

1. **REFUZOHET** si e pabazuar kërkesa e z. Pranver Hajda nga Rahoveci, me Nr. Prot. 5131 të dt. 10.11.2022, i sistemuar në punë dhe detyrat e punës Pastrues i Shtëpisë së Kulturës, pranë Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport në Komunën e Rahovecit.
2. Refuzimi sipas pikës 1 të këtij vendimi bëhet për shkak se i lartpërmenduri nuk i përmbush kushtet që të jetë përfitues i shpërblimit të përvjetorit (jubile).
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

A r s y e t i m

Më datë 10.11.2022 z. Pranver Hajda ka parashtruar kërkesë për kompensimin e pagesës jubilarë për punën e pandërprerë në shërbimin civil nga data 01.12.2001 dhe në vazhdimësi deri në ditët e sotme si Pastrues i Shtëpisë së Kulturës, pranë Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport në Komunën e Rahovecit.

Pas pranimit të kontratës së punës të të lartpërmendurit nga Njësia e Personelit, në të cilën shihet se punonjësi z. Pranver Hajda nga Rahoveci, nuk i takon kategorisë së shërbyesve civil, ashtu siç përshkruhet edhe në kontratën e marrëdhënies së punës së të lartpërmendurit, pasi që i njëjti sipas kontratës me Nr. Prot. 4300-8 të datës 31.12.2015 pozita e tij nuk është aprovuar si pozitë e shërbimit civil nga katalogu i MAP-së.

Provë: Kontrata me Nr. Prot. 4300-8 të datës 31.12.2015

Andaj, duke marrë parasysh se Ligji për Pagat e Nëpunësve Civil Nr. 03/L-147 si dhe Rregullorja Nr. 33/2012 çër Shtesat në Pagë dhe Kompensime të Tjera të Nëpunësve Civil parashih shpërblimin e përvjetorit (jubile) për kategorinë e nëpunësve civil të cilat janë në marrëdhënie të punës në Shërbimin Civil, të lartpërmendurit, nuk i takon shpërblimi i përvjetorit (jubile) sipas dispozitave të Ligjit dhe Rregullores së lartcekur si dhe duke u bazuar në kontratën e punës së të lartpërmendurit.

Andaj, pas shqyrtimit të kërkesës, në bazë të dispozitave ligjore në fuqi, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi, pala e pakënaqur, mund të parashtrojë ankesë pranë organeve kompetente, në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimi të të njëjtit.

Vendimi u dërgohet:

- **z. Pranver Hajda,**
- **Njesisë së Personelit,**
- **Arkivit.**

